



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 45/2012
Prishtinë, më 24. 01. 2012, në orën 11:00
Vila Gërmia - Prishtinë

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatçija, Fikrim Damka, Sala Berisha - Shala, Berat Buzhala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi dhe Myzejene Selmani.

Mungoi: Biserka Kostic.

Pjesëmarrës të tjerë: Shefki Kastrati, Flakërina Osmani dhe Rifat Krasniqi – NDI, Izet Ibrahimimi – këshilltar i kryetarit të Kuvendit, Agron Demi dhe Rudina Heroi – GAP, Burim Ejupi – INDEP.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, dhe konsulentja e Komisionit - Brikena Hoxha.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16. 01. 2012;
3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2012;
4. Formimi i grupit të punës për shqyrtimin e Statutit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 16. 01. 2012

Procesverbali i mbledhjes së datës 16. 01. 2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2012

Kryetari – Fillimisht e falënderoi NDI-në për mundësinë që kjo mbledhje e Komisionit të mbahet jashtë objektit të Kuvendit dhe që ka shprehur gatishmërinë t'i mbështesë aktivitetet e Komisionit edhe për vitin 2012. Theksoi se Komisioni do ta shqyrtojë këtë plan të punës dhe pas propozimeve nga ana e deputetëve, do ta miratojë në parim dhe do t'i ftojë të gjitha organizatat e shoqërisë civile për bashkëpunim të mëtutjeshëm në aktivitetet e Komisionit.

Myzejene Selmani – Për planin e punës për vitin 2012 kërkoi të bëhen disa zëvendësime. Propozoi që aktivitetet e muajit mars, që janë paraparë për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, konkretisht lidhur me shturjen ligjore të funksioneve të distribucionit dhe të furnizimit të Korporatës Energjetike të Kosovës, të kalojnë në muajin shkurt, sepse shumë shpejt pritet privatizimi i distribucionit. Për raportin e muajit prill kërkoi që strategjia e zhvillimit ekonomik të kalojë në muajin shkurt, për arsye të përgatitjes sa më të shpejtë të planit për zhvillim ekonomik.

Teuta Sahatqija – Kërkoi që Komisioni të kërkojë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik që planin e veprimit për reformat ekonomike ta sjellë sa më shpejt për shqyrtim në Komision.

Ramiz Kelmendi – Kërkoi që në plan të përfshihen edhe nisma nga Komisioni për plotësim-ndryshimin e ligjeve në sektorë të ndryshëm ekonomikë. Po ashtu, kërkoi të ftohet në takim ministri i Infrastrukturës për ta diskutuar mundësinë e formimit të një shoqërie transportuese ndërkombëtare dhe të gjendet mënyra që ta bëjnë më të përdorshme autostradën për transport ndërkombëtar dhe të shikohen mundësitë që tregtarët ta shfrytëzojnë autostradën për transport të mallrave. Gjithashtu kërkoi që për çështjen agrare të ftohet edhe ministri i Bujqësisë, për ta shqyrtuar mundësinë e miratimit të ligjeve që kanë të bëjnë me mbështetjen e fermerëve.

Sala Berisha – Shala – Propozoi që në planin e punës së Komisionit për vitin 2012 të përfshihet edhe vendimi i Komisionit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për miniera dhe minerale. Edhe pse nuk është i përfshirë në strategjinë legjislative të Qeverisë për vitin 2012, ne, si komision funksional, kemi të drejtë, në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit, ta marrim nismën ligjore për plotësim-ndryshimin e Ligjit në fjalë.

Lutfi Zharku – Tha se draftin e planit të punës për vitin 2012 e përkrah në parim, por ka disa gjëra të panevojshme. Disa detaje, që kërkohen nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, kërkoi të mos përfshihen në planin e punës së Komisionit, sepse janë çështje të brendshme të MTI-së. Ishte i mendimit që të kërkohet raport nga MTI-ja lidhur me ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet Inspektoratit të Tregut dhe të Departamentit të Metrologjisë.

Kryetari – Tha se e mirëpresin dhe e falënderojnë përkrashjen nga shoqëria civile në aktivitetet e mëtutjeshme të Komisionit. Kërkoi që në çdo tremujor të parashihet së paku mbajtja e një tryeze apo e një konference, ku do të trajtoheshin çështjet e zhvillimit ekonomik të vendit.

Të pranishëm në mbledhje të Komisionit ishin edhe **z. Agron Demi** nga **Instituti GAP** për përkrashje në monitorimin e Ligjit për zonat ekonomike dhe **z. Burim Ejupi** nga **INDEP-i**, i cili theksoi se do ta mbështetë Komisionin në amendamentimin e Projektligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Miratohet në parim plani i punës së Komisionit për vitin 2012

4. Formimi i grupit të punës për shqyrtimin e Statutit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

Kryetari - Kërkoi që për shqyrtimin e Projektstatutit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës të formohet një grup pune për ta analizuar dhe për ta shqyrtuar këtë Projektstatut, sepse kjo bie në fushën e Komisionit Funkcional.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

V E N D I M

1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Statutit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
2. Grupi i punës ka këtë përbërje: Sala Berisha – Shala, raportuese, Fikrim Damka dhe Visar Ymeri;
3. Secili anëtarë i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit të punës gjatë punës së tij;
4. Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësinë Koordinuese të Komisionit, të hartojë planin e veprimit dhe pastaj ta përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe për miratim në Komision.

5. Të ndryshme

Çështje vijuese

Kryetari - Njoftoi se nesër do të këtë mbledhje të Komisionit për shqyrtimin në parim të projektligjeve, që janë në procedurë dhe për një letër-ftesë për takim nga Oda Ekonomike e Kosovës dhe nga Oda e Zëjtarisë së Dortmundit për aftësimin profesional, si indikator i zhvillimit ekonomik.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit